



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË  
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 1  
21.04.2017

NR. VENDIMI 5  
16.03.2018

VENDIM  
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me trup gjykues të përbërë nga:

**Luan HASNEZIRI – Kryesues**

**Daniela SHIRKA – Anëtare**

**Miliana MUÇA – Anëtare**

asistuar nga sekretare **Andina Kaja**, sot në datë 16.3.2018, përfundoi në seancë gjyqësore publike, gjykimin e çështjes me Nr. 1/17 Regjistri, që i përket palëve:

**PADITËSE:** Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, e përfaqësuar në gjykim nga prokurori Klodian Braho.

**I PADITUR:** 1.M. F. i biri i P. dhe i L., i datëlindjes xxxx, lindur në xxxx dhe banues në xxxx, me adresë rruga “xxxx”, banesë private Nr.xx, me gjëndje civile, xxxx me x fëmijë, me arsim xxxx, përfaqësuar në gjykim, nga Av. T. P..

**PERSONA TË TRETË:** 1. Shoqëria “xxxx” sh.p.k, me Nipt xxxx, me adresë: Rruga "xxxx"pallati xx, hyrja x, apartamenti x, xxxx, në mungesë.

2. Shoqëria “xxxx”, sh.p.k, me Nipt xxxx, me adresë xxxx, “xxxx” Tiranë, në mungesë.

3. Sh. S. i biri i B. dhe i N., i datëlindjes xxxx, lindur dhe banues në xxxx, në mungesë.

4. Shoqëria “xxxx”, sh.a, me Nipt xxxx, me adresë Rruga “xxxx”, godina Nr. x, në mungesë, përfaqësuar nga avokati i caktuar kryesisht, avokat A. P..

5. D. F., banuese në Rrugën “xxxx”, xxxx, në mungesë, përfaqësuar nga avokati i caktuar kryesisht, avokat R. P..

**OBJEKTI: I.** Konfiskim i pasurive të mëposhtme:

1. Pasuria e paluajtshme me nr.xxxxx, zona kadastrale me Nr. xxxx, volumi x, faqe x, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, ndodhur në xxxx, xxxx.
2. Pasuria e paluajtshme me Nr. xxxx, zona kadastrale nr.xxxx, volumi x, faqe x, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, ndodhur në xxxx, xxxx.
3. Pasuria e paluajtshme e llojit dyqan, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “xxxx”, xxxx, ndodhur në objektin banimi dhe shërbimi x dhe x kate, të ndërtuar nga subjekti ndërtues “xxxx” sh.p.k, me lejën e ndërtimit të miratuar me vendimin Nr. xxx, datë xxxx të KRRT-së së Bashkisë xxxx.
4. Pasuria e paluajtshme e llojit apartament, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, me numër pasurie xxxx, zona kadastrale nr.xxxx, ndodhur në xxxx, xxxx, e regjistruar në rregjistrin hipotekor në Nr. xxxx, datë xxxx, ndodhur në katin e xxxx banimi, shkalla x, apartamenti me nr.xxxx.
5. Pasuria e paluajtshme, e llojit apartament, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, me numër pasurie xxxx, zona kadastrale Nr. xxxx, ndodhur në xxxx, xxxx, e regjistruar në rregjistrin hipotekor në Nr. xxxx, datë xxxx, ndodhur në katin e x banimi, shkalla x, apartamenti me nr.xxxx.
6. Pasuria e paluajtshme e llojit bodrum, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, me numër pasurie xxxx, zona kadastrale Nr. xxxx, ndodhur në xxxx, xxxx, e regjistruar në rregjistrin hipotekor në Nr. xxx, datë xxxx, ndodhur në katin e x nëntokë, shkalla x, bodrumi Nr. x.
7. Pasuria e paluajtshme e llojit bodrum, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, me numër pasurie xxxx, zona kadastrale nr.xxxx, ndodhur në xxxx, xxxx, e regjistruar në rregjistrin hipotekor në Nr. xxxx, datë xxxx, ndodhur në katin e x nëntokë, shkalla x, bodrumi Nr. x.
8. Pasuria e paluajtshme e llojit dyqan, me sipërfaqe xxx m<sup>2</sup>, të ndodhur në objektin me x kate, të ndërtuar nga shoqëria “xxxx” sh.p.k, me lejen e ndërtimit të miratuar me vendimin Nr. xxx, datë xxxx të KRRT-së së Bashkisë xxxx, me pronar truall familja xxxx.
9. Pasuria e paluajtshme nr.xxxx zona kadastrale Nr. xxxx, volumi xx, faqe x, e llojit truall, me sipërfaqe xxx m<sup>2</sup> dhe ndërtesë, me sipërfaqe xxx m<sup>2</sup>, ndodhur në xxxx, xxxx.

**II.** Pushimin e gjykimit për konfiskimin e pasurisë së mëposhtme:

Pasurisë Nr.xxxx, zona kadastrale nr.xxxx, e llojit arë, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, ndodhur në xxxx, si dhe shuarjen e masës së sekuestrimit, për këtë pasuri, të vendosur me vendimin Nr. xx, datë xxxx të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Ligji Nr. 10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar.

Gjykata, pasi shqyrtoi provat dhe analizoi në tërësi rrethanat e çështjes, dëgjoi pretendimet

përfundimtare të prokurorit, i cili, kërkoi:

I. Konfiskimin e pasurive të paluajtshme në zotërim të shtetasit M. F., si më poshtë vijon:

1. Pasuria e paluajtshme me nr.xxxx, zona kadastrale me Nr. xxxx, volumi x, faqe x, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, ndodhur në xxxx, xxxx.

2. Pasuria e paluajtshme me Nr. xxxx, zona kadastrale nr.xxxx, volumi x, faqe x, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, ndodhur në xxxx, xxxx.

3. Pasuria e paluajtshme e llojit dyqan, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “xxxx”, xxxx, ndodhur në objektin banimi dhe shërbimi x dhe x kate, të ndërtuar nga subjekti ndërtues “xxxx” sh.p.k, me lejën e ndërtimit të miratuar me vendimin Nr. xxx, datë xxxx të KRRT-së së Bashkisë xxxx.

4. Pasuria e paluajtshme e llojit apartament, me sipërfaqe xxx m<sup>2</sup>, me numër pasurie xxxx, zona kadastrale nr.xxxx, ndodhur në xxxx, xxxx, e regjistruar në rregjistrin hipotekor në Nr. xxxx, datë xxxx, ndodhur në katin e xxxx banimi, shkalla x, apartamenti me nr.xxx.

5. Pasuria e paluajtshme, e llojit apartament, me sipërfaqe xxx m<sup>2</sup>, me numër pasurie xxxx, zona kadastrale Nr. xxxx, ndodhur në xxxx, xxxx, e regjistruar në rregjistrin hipotekor në Nr xxx, datë xxxx, ndodhur në katin e xxxx banimi, shkalla x, apartamenti me Nr. xx.

6. Pasuria e paluajtshme e llojit bodrum, me sipërfaqe xxx m<sup>2</sup>, me numër pasurie xxxx, zona kadastrale Nr. xxxx ndodhur në xxx, xxxx, e regjistruar në rregjistrin hipotekor në Nr. xxx, datë xxxx, ndodhur në katin e xxx nëntokë, shkalla x bodrumi Nr .x.

7. Pasuria e paluajtshme e llojit bodrum, me sipërfaqe xxx m<sup>2</sup>, me numër pasurie xxxx zona kadastrale nr.xxxx, ndodhur në xxxx, xxxx, e regjistruar në rregjistrin hipotekor në Nr. xxx, datë xxxx, ndodhur në katin e xxxx nëntokë, shkalla x, bodrumi Nr. x.

8. Pasuria e paluajtshme e llojit dyqan, me sipërfaqe xxx m<sup>2</sup>, të ndodhur në objektin me xx kate, të ndërtuar nga shoqëria “xxxx” sh.p.k, me lejen e ndërtimit të miratuar me vendimin Nr. xxx, datë xxxx të KRRT-së së Bashkisë xxxx, me pronar trualli familja xxxx.

9. Pasuria e paluajtshme nr.xxxx, zona kadastrale Nr. xxxx, volumi x, faqe x, e llojit truall, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup> dhe ndërtesë, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, ndodhur në xxxx, xxxx.

II. Pushimin e gjykimit për konfiskimin e pasurisë së mëposhtme:

Pasurisë Nr.xxxx, zona kadastrale nr.xxxx, e llojit arë, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, ndodhur në xxxx, si dhe shuarjen e masës së sekuestrimit, për këtë pasuri, të vendosur me vendimin Nr. xxxx, datë xxxx të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë.

III. Për administrimin dhe përdorimin e pasurive të ngarkohet Agjensia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, administrator Z. S. M..

IV. Shpenzimet procedurale t’iu ngarkohen shtetasit M. F. dhe personave të tretë në mënyrë solidare.

Pasi dëgjoi në diskutimin përfundimtar mbrojtësin e të paditurit M. F., avokat T. P., i cili, kërkoi, rrëzimin e kërkesës së paraqitur nga prokurori, si të pabazuar në prova e ligj.

Pasi dëgjoi në diskutimin përfundimtar mbrojtësit e personave të tretë “xxxx” sh.a dhe

D. F., të cilët kërkuan rrëzimin e kërkesës së paraqitur nga prokurori, si të pabazuar në prova e ligj, në mungesë të personave të tretë shoqërisë “xxxx” sh.p.k, shoqërisë “xxxx”, sh.p.k dhe Sh. S..

## V Ë R E N:

**1.** Me datë xxxx, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, ka paraqitur kërkesë, me objekt konfiskimin e pasurive në përdorim dhe në pronësi të të paditurit M. F., sipas listës së pasurisë të cituar në pjesën hyrëse të këtij vendimi, duke e bazuar kërkesën e saj në ligjin Nr. 10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar.

**2.** Në seancën e parë gjyqësore, pas legjitimitit të palëve, përfaqësuesi i prokurorisë, në bazë të nenit 193 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe nenit 22, pika 3 të Ligjit të posaçëm Nr. 10 192, datë 3.12.2009, kërkoi që të thirren si persona të tretë në gjykim, shoqëria “xxxx” sh.p.k, shoqëria “xxxx”, sh.p.k, shtetasi Sh. S., shoqëria “xxxx”, sh.a, dhe shtetasja D. F., kërkesë, e cila u pranua nga gjykata, sepse, duke iu referuar akteve dhe provave të dosjes, rezultoi që, këta persona fizikë dhe juridikë, kishin kontribuar në krijimin e pasurive në përdorim dhe pronësi të të paditurit M. F., të cilat ishin objekt konfiskimi.

**3.** Pasi vendosi thirrjen në gjykim me cilësinë e personit të tretë të personave të mësipërm, gjykata bëri njoftimin e tyre, me anë të policisë gjyqësore, me qëllim që ata të merrnin pjesë në seancë gjyqësore, ku, pas procedurës së njoftimit rezultoi që, personat e tretë shoqëria “xxxx” sh.p.k, shoqëria “xxxx”, sh.p.k dhe shtetasi Sh. S., morën dijeni për ditën dhe orën e seancës gjyqësore dhe, zgjodhën që të mos paraqiteshin në gjykim dhe për këtë arsye, gjykata, në bazë të nenit 22 të ligjit Nr. 10 192, datë 3.12.2009, sipas ndryshimeve të bëra me ligjin Nr. 70/2017, i konsideroi ata si të pranishëm, duke vijuar gjykimin në mungesë të tyre, pa iu caktuar mbrojtës kryesisht, ndërsa, personat e tretë shoqëria “xxxx”, sh.a, dhe shtetasja D. F., rezultoi që, nuk morën dijeni personalisht për gjykimin dhe, në këto kushte, në bazë të nenit 22 të ligjit të mësipërm, sipas ndryshimeve të bëra me ligjin Nr. 70/2017, gjykata, vendosi të deklaroi mosgjatjen e tyre, si dhe të caktoi avokat kryesisht, për të mbrojtur interesat e tyre në gjykim, duke caktuar avokatin A. P. për mbrojtjen e interesave të shoqërisë “xxxx”, sh.a dhe avokatin R. P. për mbrojtjen e interesave të shtetases D. F.

**4.** Nga shqyrtimi i akteve dhe provave të këtij gjykimi rezultoi e provuar që, në kuadër të procedimit penal Nr. x, viti xxxx të Prokurorisë së Përgjithshme, shtetasi M. F. është akuzuar se ka kryer veprat penale të: “Vrasja me paramendim”, në bashkëpunim, “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rreme i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë”, “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, “Ndërtimi i paligjshëm”, të parashikuara nga nenet 78/1 e 25, 257/a/2, 287, gërma (b) dhe 199/a/2 i Kodit Penal.

5. Me vendimin Nr. xxxx, datë xxxx të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxxx, të lënë në fuqi me vendimin Nr. xxxx, datë xxxx të Gjykatës së Apelit xxxx, shtetasi M. F. është deklaruar fajtor dhe është dënuar për veprat penale “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rreme i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë”, “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, “Ndërtimi i paligjshëm”, të parashikuara nga nenet 257/a/2, 287, gërma (b) dhe 199/a/2 i Kodit Penal. Po ashtu, rezulton se, shtetasi M. F., me vendimin Nr. xxx/xxxxx, datë xxxx të Gjykatës së xxxx, është dënuar me x vjet burgim, për veprimtarinë kriminale të trafikimit të lëndëve narkotike, duke përdorur atje emrin P. S., i datëlindjes xxxx, lindur në xxxx, xxxx.

6. Duke iu referuar përmbjatjes së vendimeve gjyqësore, rezulton që, i padituri M. F. është deklaruar fajtor për veprën penale të: “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të parashikuar nga neni 287, gërma (b) të Kodit Penal, pasi, ai në periudhën xxxx, deri në vitin xxxx, ka krijuar një pasuri prej xxxx lekë, që nuk justifikohet me burime financiare të ligjshme, duke u provuar në gjykim se, pasuria në fjalë është produkt i veprimtarisë së paligjshme të trafikimit të lëndëve narkotike, të kryer përgjatë viteve xxxx-xxxx. Në vendimin penal të formës së prerë është arsyetuar që, nga shqyrtimi gjyqësor i kryer dhe të dhënat e grumbulluara nga burimet e provave ka rezultuar se, kjo pasuri e krijuar nga shtetasi M. F. është produkt i veprimtarisë së paligjshme të trafikimit të lëndëve narkotike të kryer prej tij. Nëpërmjet krijimit të shoqërive tregtare tregtare, i padituri ka mbuluar dhe fshehur paratë e siguruar nga veprimtaria e paligjshme kriminale e mësipërme.

7. Nisur nga rrethanat e mësipërme, duke qënë se, ndaj të paditurit M. F., ekziston një vendim dënimi nga autoritetet xxxx të drejtësisë, për fakte që parashikohen si vepër penale nga neni 283/a i Kodit Penal, duke qënë se, ndaj tij ekziston një vendim dënimi se, ka kryer veprën penale të parashikuar nga neni 287, gërma (b) të K.Penal, duke pastruar produkte edhe të rrjedhura nga vepra penale e parashikuar nga neni 114/2 të K.Penal, në bazë të nenit 3/1, gërmat (ç) dhe (d) të ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i paditurit M. F. është subjekt i masave parandaluese pasurore, sipas këtij ligji.

8. Në lidhje me pasuritë në zotërim të të paditurit M. F. dhe të afërmëve të tij, nga ana e akuzës janë kryer të gjitha verifikimet e nevojshme pasurore, për të verifikuar të gjitha pasuritë në zotërim të tij, për të cilat provohet se, nuk kanë prejardhje të ligjshme, nga ku, organi i akuzës ka arritur në përfundimin që, nga ky shtetas nuk justifikohen të ardhurat e siguruar, në mënyrë të ligjshme, për pasuritë e mëposhtme:

- Pasuria e paluajtshme me nr. xxxx, zona kadastrale me Nr. xxxx, volumi x, faqe xxx, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, ndodhur në xxxx, xxxx.

- Pasuria e paluajtshme me Nr. xxxx, zona kadastrale nr. xxxx, volumi x, faqe xx

me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, ndodhur në xxxx, xxxx.

- Pasuria e paluajtshme e llojit dyqan, me sipërfaqe xxx m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “xxxx”, xxxx, ndodhur në objektin banimi dhe shërbimi x dhe x kate, të ndërtuar nga subjekti ndërtues “xxxx” sh.p.k, me lejen e ndërtimit të miratuar me vendimin Nr. xxx, datë xxxx të KRRT-së së Bashkisë xxxx.

- Pasuria e paluajtshme e llojit apartament, me sipërfaqe xxx m<sup>2</sup>, me numër pasurie xxxx, zona kadastrale nr.xxxx, ndodhur në xxxx, xxxx, e regjistruar në regjistrin hipotekor në Nr. xxx, datë xxxx, ndodhur në katin e xxxx banimi, shkalla x, apartamenti me nr.xx.

- Pasuria e paluajtshme, e llojit apartament, me sipërfaqe xxx m<sup>2</sup>, me numër pasurie xxxx, zona kadastrale Nr. xxxx, ndodhur në xxxx, xxxx, e regjistruar në regjistrin hipotekor në Nr .xxx, datë xxxx, ndodhur në katin e x banimi, shkalla x, apartamenti me Nr. x.

- Pasuria e paluajtshme e llojit bodrum, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, me numër pasurie xxxx, zona kadastrale Nr. xxxx, ndodhur në xxxx, xxxx, e regjistruar në regjistrin hipotekor në Nr. xxx, datë xxxx, ndodhur në katin e xxx nëntokë, shkalla x, bodrumi Nr. x.

- Pasuria e paluajtshme e llojit bodrum, me sipërfaqe xxx m<sup>2</sup>, me numër pasurie xxxx, zona kadastrale nr.xxxx, ndodhur në xxxx, xxxx, e regjistruar në regjistrin hipotekor në Nr. xxxx, datë xxxx, ndodhur në katin e xxxx nëntokë, shkalla x, bodrumi Nr. x.

- Pasuria e paluajtshme e llojit dyqan, me sipërfaqe xxx m<sup>2</sup>, të ndodhur në objektin me xxx kate, të ndërtuar nga shoqëria “xxxx” sh.p.k, me lejen e ndërtimit të miratuar me vendimin Nr. xxx, datë xxxx të KRRT-së së Bashkisë xxxx, me pronar truall familja xxxx.

- Pasuria e paluajtshme nr.xxxx, zona kadastrale Nr. xxxx, volumi xx, faqe xx, e llojit truall, me sipërfaqe xxx m<sup>2</sup> dhe ndërtesë, me sipërfaqe xxx m<sup>2</sup>, ndodhur në xxx, xxxx.

**9.** Përfaqësuesi i të paditurit M. F., si dhe përfaqësuesit e personave të tretë “xxxx” sh.a dhe D. F., pretenduan që, pasuritë objekt konfiskimi në përdorim dhe në pronësi të të paditurit M. F., janë siguruar me të ardhura të ligjshme prej të paditurit M. F. dhe familjarëve të tij, duke kërkuar rrëzimin e kërkesës së prokurorit për konfiskimin e këtyre pasurive, si të pabazuar në prova dhe ligj.

**10.** Duke u bazuar në aktet dhe provat e mësipërme, gjykata arrin në përfundimin që, nga ana e organit të akuzës është përmbushur barra e saj e provës e parashikuar nga neni 3, pika 1 të ligjit Nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar, sipas të cilit prokurori ka barrën e provës që të provojë që, ekzistojnë dyshime të arsyeshme, të bazuara në indicie se, i padituri ose personi i tretë, ka marrë pjesë në një nga veprat penale të parashikuara nga pika 1 e nenit 3 të ligjit në fjalë. Në rastin konkret, duke iu referuar akteve dhe provave të shqyrtuara, rezultojnë e provuar jo vetëm që, ekzistojnë dyshime të arsyeshme, të bazuara në indicie se, i padituri M. F., ka kryer një nga veprat penale të parashikuara nga pika 1 e nenit 3 të ligjit, por ekzistojnë prova të plota që, ai ka kryer dy nga këto vepra penale, siç janë trafikimi i narkotikëve dhe pastrimi i produkteve të veprës penale, për të cilat ai është dekluar fajtor për kryerjen e tyre, me vendim të formës së prerë dhe, në këto kushte, është tepër e qartë që, nga ana e akuzës, është përmbushur barra e provës nga ana e tij.

**11.** Gjykata për të verifikuar pretendimet e palëve, nëse, nga ana e të paditurit M. F. dhe familjarëve të tij, në lidhje me pasuritë objekt konfiskimi, janë krijuar apo jo me anë të të ardhurave të ligjshme, vendosi që të caktoi kryerjen e dy akteve të ekspertimit; të një akti ekspertimi kontabël, me anë të të cilit të përcaktohej vlera e të ardhurave dhe shpenzimeve të të paditurit M. F. dhe familjarëve të tij, për periudhën nga data xxxx, deri më xxxx, si dhe të një akti ekspertimi vlerësues, ku, të përcaktohej vlera e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të të paditurit M. F. dhe familjarëve të tij, për të njëjtën periudhë. Në vijim, gjykata, në seancë gjyqësore, duke konstatuar që, pasuria e fundit objekt konfiskimi ishte fituar nga i padituri M. F. dhe familjarët e tij, me datë xxxx, bëri saktësimin e periudhës për ekspertin kontabël dhe ekspertin vlerësues, ku, atyre iu caktuar si detyrë që të përcaktonin vlerën e të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe vlerën e pasurive të të paditurit M. F. dhe familjarëve të tij, nga data xxxx, deri më datë xxxx, pasi përcaktimi i të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe i vlerës së pasurisë së të paditurit M. F. dhe familjarëve të tij, pas datës xxxx, dilte jashtë objektit të këtij gjykimi dhe nuk i interesonte këtij gjykimi, në kushtet kur, pasuria e fundit e fituar nga i padituri M. F. dhe familjarët e tij, ishte me datë xxxx.

**12.** Bazuar në aktin e ekspertimit kontabël, në aktin e ekspertimit vlerësues, në shtesat e këtyre akteve të ekspertimit, të hartuar dhe të paraqitur nga ekspertët në seancë gjyqësore, si dhe bazuar në të gjitha aktet dhe provat e tjera, rezultoi që, të ardhurat dhe shpenzimet e të paditurit M. F. dhe familjarët e tij, janë si më poshtë:

**Për vitin xxxx,** ka realizuar këto të ardhura dhe shpenzime; **Pasuri:** banesë private x kate, xxx m<sup>2</sup>, në proces legalizimi; **të ardhura,** pension P. F., 1991-1998, gjithsej = xxxx lekë, pension L. F., 1993-1998, gjithsej = xxxx lekë; **Shpenzime për pasuritë dhe jetesën;** Konsum familjar 1991-1998, gjithsej xxxx lekë; Kostoja e ndërtimit të banesës private, në masën ½ pjesë, xxxx lekë, sipas aplikimit të Aluizni-t, objekti është bashkëpronësi të të paditurit M. F. dhe shtetasit A. F..

**13. Për periudhën e viteve 1999-2002,** të ardhurat dhe shpenzimet e të paditurit M. F. dhe familjarëve të tij, janë; **Pasuri:** “xxxx” sh.p.k, Nipt xxxx, krijuar në datë xxxx, aktualisht kaluar në status pasiv. **Të ardhura:** pension P. F., 1999-2002 = xxxx lekë, pension L. F., 1990-2002 = xxxx lekë, të ardhura nga “xxxx” sh.p.k, xxxx lekë, të ardhura si i punësuar në shoqërinë si më sipër, xxxx lekë. **Shpenzime për pasuritë dhe jetesën:** konsum familjar, 1999-2002 = xxxx lekë. Shpenzim për ngritjen e aktivitetit tregtar, minimalisht xxxx lekë. Nga verifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën 1991-2002, totali i të ardhurave të të paditurit M. F. dhe familjarëve të tij është xxxx (xxxx) lekë; totali i shpenzimeve është xxxx (xxxx) lekë, ndërsa, **totali i shpenzimeve të pajustificuara ligjërsht është: xxxx (xxxx) lekë.**

**14. Për vitin 2003** të ardhurat dhe shpenzimet e të paditurit M. F. dhe familjarëve të tij, janë; **të ardhura;** pension P. F. = xxxx lekë; pension L. F. = xxxx lekë; të ardhura gjithësej = xxxx lekë. **Shpenzime për pasuritë dhe jetesën;** Konsum familjar = xxxx lekë, nga ku, rezulton që, për vitin 2003, **shpenzime të pajustificuara**

**ligjërisht janë: xxxx (xxxx) lekë.**

**15. Për periudhën e viteve 2004-2009**, të ardhurat dhe shpenzimet e të paditurit M. F. dhe familjarëve të tij, janë; **Pasuri:** xxxx sh.p.k, me Nipt xxxx, rregjistruar në datë xxxx, M. F. 50 % ortak, kapitali fillestar xxxx lekë. person fizik, me Nipt xxxx, rregjistruar në datë xxxx, aksione në masën 50 % të aksioneve të shoqërisë “xxxx” sh.a, blerë me kontratën Nr. xxx Rep dhe Nr. xxx Kol, datë xxxx, në shumën xxxx lekë. **Të ardhura:** Të ardhura nga paga neto e të paditurit M. F. nga shoqëria “xxxx” sh.p.k, viti 2008 = xxxx lekë; të ardhura nga paga neto e personit të tretë D. F. nga shoqëria “xxxx” sh.p.k, viti 2008 = xxxx lekë, të ardhura nga paga neto e të paditurit M. F., nga shoqëria “xxxx” sh.p.k, viti 2009 = xxxx lekë, të ardhura nga paga neto dhe qiraje e të paditurit M. F., viti 2009 = xxxx lekë, të ardhura nga paga neto nga shoqëria “xxxx” sh.p.k, e personit të tretë D. F., viti 2009 = xxxx lekë, të ardhura të të paditurit M. F., si administrator i xxxx, viti 2009 = xxxx lekë, të ardhura të derdhura në llogari nga shoqëria “xxxx” sh.a, në shumën = xxxx lekë, pension P. F., 2004-2009, gjithsej = xxxx lekë, pension L. F. 2004-2009, gjithsej = xxxx lekë. **Shpenzime për pasuritë dhe jetesën** janë; Konsum familjar, 2004-2009 = xxxx lekë. Shpenzim per kapitalin e shoqërisë xxxx sh.p.k = xxxx lekë. Shpenzimet për blerjen e 50 % të aksioneve të shoqërisë “xxxx” sh.a = xxxx lekë. Si përfundim, për periudhën 2004-2009, totali i të ardhurave të të paditurit M. F. dhe familjarëve të tij është xxxx (xxxx) lekë; totali i shpenzimeve është xxxx (xxxx) lekë dhe **shpenzime të pajustificuara ligjërishtë janë: xxxx = minus -xxxx (xxxx) lekë.**

**16. Për vitin 2010**, të ardhurat dhe shpenzimet e të paditurit M. F. dhe familjarëve të tij, janë; **Pasuri:** Dyqan me sipërfaqe xxx m<sup>2</sup>, rruga “xxxx”, xxxx, blerë me kontratën Nr. xxxx Rep dhe Nr. xxxx Kol, dt.xxxx, për çmimin xxxx euro = xxxx lekë; Pasuria Nr. xxxx, zk. xxxx, lloji dyqan, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, ndodhur në xxxx, blerë me kontratën Nr. xxxx Rep dhe Nr. xxxx Kol, dt.xxxx, për çmimin prej xxxx lekë; Pasuria Nr. xxxx, zk. xxxx, lloji dyqan, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, ndodhur në xxxx, blerë me kontratën Nr. xxxx Rep dhe Nr. xxxx Kol, dt.xxxx, për çmimin prej xxxx lekë; Blerje 33 % të aksioneve të shoqërisë “xxxx” sh.p.k, Nipt xxxx, për çmimin prej xxxx lekë. **Të ardhura:** Pagë nga xxxx e të paditurit M. F., shuma = xxxx lekë; Derdhje në llogari nga shoqëria “xxxx” sh.a, në shumën = xxxx lekë; Pension P. F. = xxxx lekë; Pension L. F. = xxxx lekë. Shpenzime për pasuritë dhe jetesën: Kontratë blerje Nr. xxxx Rep dhe Nr. xxxx Kol, datë xxxx, të pasurisë me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, rruga “xxxx”, xxxx, çmimi xxxx euro = xxxx lekë, (sipas aktit vlerësues vlera e tregut të kësaj pasurie, në momentin e blerjes është = xxxx lekë); Kontratë blerje Nr. xxxx Rep dhe Nr. xxxx Kol, datë xxxx, të pasurisë Nr. xxxx, zk. xxxx, lloji dyqan, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, ndodhur në xxxx, çmimi xxxx lekë, (sipas aktit vlerësues vlera e tregut, në momentin e blerjes është e = xxxx lekë); Kontratë blerje Nr. xxxx Rep dhe Nr. xxxx Kol, datë xxxx, të pasurisë Nr. xxxxx, zk. xxxx, lloji dyqan, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, ndodhur në xxxx, çmimi xxxx lekë, (sipas aktit vlerësues vlera e tregut, në momentin e blerjes është e = xxxx lekë); Blerje 33 % të aksioneve të “xxxx”



sh.p.k, për çmimin xxxx lekë; Transfertë në USA, me anë të xxxx, në shumën xxxx usd = xxxx lekë; Konsum familjar në shumën xxxx lekë. **Për vitin 2010**, totali i të ardhurave është xxxx lekë, totali i shpenzimeve për pasuritë dhe jetesën xxxx lekë dhe **totali i shpenzimeve të pajustificuara ligjërisht është: xxxx = xxxx lekë xxxx) lekë.**

**17. Për vitin 2011**, të ardhurat dhe shpenzimet e të paditurit M. F. dhe familjarëve të tij, janë; **Pasuri:** Automjet xxxx, me targa xxxx, blerë në datë xxxx, në shumën xxxx euro = xxxx lekë. **Të ardhura:** Derdhje në llogari në xxxx nga shoqëria “xxxx” sh.a, në shumën =xxxx lekë; Derdhje në llogari në xxxx, nga E. Xh., I. L., nga shoqëria “xxxx” sh.a, total në shumën = xxxx lekë. Pagë e të paditurit M. F., si administrator “xxxx” shuma = xxxx lekë; Pagë e personit të tretë D. F. nga shoqëria “xxxx” sh.a, viti xxxx = xxxx lekë; Pension P. F. = xxxx lekë; Pension L. F. = xxxx lekë. **Shpenzime për pasuritë dhe jetesën:** Blerje e automjetit me targa xxxx, blerë në datë xxxx, në shumën xxxx euro = xxxxx lekë. Transfertë në USA me anë të xxxx, në shumën xxxx USD = xxxx lekë; Konsum familjar në shumën xxxx lekë. **Për vitin 2011**, Totali i të ardhurave është: xxxx lekë; totali i shpenzimeve për pasuritë dhe jetesën është: xxxx lekë; **Totali i shpenzimeve të pajustificuara ligjërisht është: xxxx = mimis xxxx (xxxxx) lekë.**

**18. Për vitin 2012**, të ardhurat dhe shpenzimet e të paditurit M. F. dhe familjarëve të tij, janë; **Pasuri:** Pasuria me Nr. xxxx, zk. xxxx, lloji apartament, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, ndodhur në xxxx, blerë me kontratën Nr. xxxx Rep dhe Nr. Xxxx Kol, datë xxxx, për çmimin xxxx euro = xxxx lekë; Pasuria me Nr. xxxx, zk. xxxx, lloji apartament, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, ndodhur në xxxx, blerë me kontratën Nr. xxxx Rep dhe Nr. xxxx Kol, datë xxxx, për çmimin xxxx lekë; Pasuria me Nr. xxxx, zk. xxxx, lloji bodrum, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, ndodhur në xxxx, blerë me kontratën Nr. xxxx Rep dhe Nr. xxxx Kol, datë xxxx, për çmimin xxxx lekë; Pasuria me Nr. xxxx, zk. xxxx, lloji bodrum, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, ndodhur në xxxx, blerë me kontratën Nr. xxxx Rep dhe Nr. xxxx Kol, datë xxxx, për çmimin xxxx lekë; Dyqan me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, xxxx, xxxx, blerë me kontratën Nr. xxx Rep dhe Nr. xxx Kol, datë xxxx, për çmimin xxxx euro = xxxx lekë; Automjet me targa xxxx, blerë me kontratën e datës xxxx nga xxxx, me çmimin xxxx euro, pjesa e detyrimit të mbetur xxxx euro principal dhe xxxx euro fatura të paarkëtuara; Automjet me targa xxxx, blerë në vitin 2012, me çmimin xxxx euro =xxxx lekë; Automjet xxxx, me targa xxxx, kontratë për zëvendësimin e qiramarrësit datë xxxx, sipas të cilës i padituri M. F. ka shlyer në datën xxxx detyrimin prej xxxx euro = xxxx lekë. **Të ardhura:** Pagë nga xxxx M.F., shuma = xxxx lekë; Derdhje në llogari të të paditurit M. F. nga shtetasi E. K., në shumën = xxxx lekë; Pagë e të paditurit M. F., si administrator “xxxx” shuma = xxxx lekë; Pagë e personit të tretë D. F. nga shoqëria “xxxx” sh.a, viti 2012 = xxxx lekë; Pagë e personit të tretë D. F. nga shoqëria “xxxx” sh.a, viti 2012 = xxxx lekë; Pension P. F. = xxxx lekë; Pension L. F. = xxxx lekë. **Shpenzime për pasuritë dhe jetesën:** Kontratë blerje Nr. xxxx Rep dhe Nr. xxxx Kol, datë xxxx, të pasurisë Nr. xxxx, zk. xxxx, lloji apartament, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, ndodhur në xxxx, çmimi xxxx lekë (Sipas aktit vlerësues vlera e tregut, në momentin

e blerëjes është e = xxxx lekë); Kontratë blerje Nr. xxxx Rep dhe Nr. xxxx Kol, datë xxxx, të pasurisë nr.xxxx, zk.xxxx, lloji apartament, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, ndodhur në xxxx, çmimi xxxx lekë (Sipas aktit vlerësues vlera e tregut në momentin e blerëjes është = xxxx lekë); Kontratë blerje Nr. xxxx Rep dhe Nr. xxxx Kol datë xxxx, të pasurisë Nr. xxxx, zk. xxxx, lloji bodrum, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, ndodhur në xxxx, çmimi xxxx lekë; Kontratë blerje Nr. xxxx Rep dhe Nr. xxxx Kol, datë xxxx, të pasurisë nr.xxxx, zk.xxxx, lloji bodrum, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, ndodhur në xxxx, çmimi xxxx lekë; Kontratë blerje Nr. xxx Rep dhe Nr. xxx Kol, datë xxxx, të pasurisë me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, xxxx, xxxx, çmimi xxxx euro = xxxx lekë (Sipas aktit vlerësues vlera e tregut në momentin e blerëjes është = xxxx lekë); Blerje e automjetit targa xxxx, blerë me kontratën e datës xxxx nga xxxx, çmimi i paguar xxxx lekë; Blerje e automjetit në targa xxxx, blerë në vitin 2012, me çmimin xxxx euro = xxxx lekë. Automjet me targa xxxx, kontratë për zëvendësimin e qiramarrësit datë xxxx, sipas të cilës i padituri M. F. ka shlyer në datën xxxx detyrimin prej xxxx euro = xxxx lekë; Dhënie hua shtetasit R. M., me kontratën Nr. xxxx Rep dhe Nr. xxxx Rep, datë xxxx, në shumën xxxx euro = xxxx lekë; Konsum familjar në shumën xxxx lekë. **Për vitin 2012;** Totali i të ardhurave është xxxx lekë; totali i shpenzimeve për pasuritë dhe jetesën është: xxxx lekë dhe **totali i shpenzimeve të pajustificuara ligjërisht është: xxxxx (xxxxx) lekë.**

**19. Për periudhën nga 1 janari, deri më datë 12.6.2013,** të ardhurat dhe shpenzimet e të paditurit M. F. dhe familjarëve të tij, janë; **Pasuri:** Pasuria pemëtore në xxxx, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, Nr. xxxx, zk.x xxx, blerë nga personi i tretë D. F. me kontratën Nr. xxxx Rep dhe Nr. xxx Kol, datë xxxx, për çmimin prej xxxx lekë; Pasuria Nr. xxxx zk. xxxx, lloji truall me sipërfaqe xxx m<sup>2</sup> dhe xxx m<sup>2</sup> ndërtesë, blerë nga personi i tretë D. F. me kontratën Nr. xxxx Rep dhe Nr. xxx Kol, datë xxxx, për çmimin xxxx lekë. **Të ardhura:** Të ardhura nga shitja e 20 % të aksioneve të shoqërisë “xxxx” sh.a, me kontratën Nr. xxxx Rep dhe Nr. xxxx Kol, datë xxxx, në shumën =xxxx lekë; Të ardhura të të paditurit M. F., nga paga në shumën xxxx lekë; Të ardhura nga paga e të paditurit M. F. nga subjekti “xxxx”, në shumën xxxx lekë; Të ardhura të të paditurit M. F. nga shoqëria “xxxx” në shumën xxxx lekë; Të ardhura e personit të tretë D. F. nga shoqëria “xxxx” në shumën xxxx lekë; Pension P. F., në shumën xxxx lekë; Pension L. F., në shumën xxxx lekë; Të ardhura nga “xxxx” sh.p.k, në Kosovë, shuma xxxx lekë. **Shpenzime për pasuritë dhe jetesën:** Kontratë blerje Nr. xxxx Rep dhe Nr. xxx Kol, datë xxxx, të pasurisë Nr. xxxx, zk. xxxx, lloji pemëtore, me sipërfaqe xxx m<sup>2</sup>, nga personi i tretë D. F., ndodhur në xxxx, çmimi xxxx lekë; Kontratë blerje Nr. xxxx Rep dhe Nr.xxxx Kol, datë xxxx, të pasurisë Nr. xxxx, zk. xxxx, truall me sipërfaqe xxx m<sup>2</sup> dhe xxx m<sup>2</sup> ndërtesë, nga personi i tretë D. F., ndodhur në xxxx, çmimi xxxx lekë; Konsum familjar në shumën xxxx lekë.

**20.** Për vitin 2013, nga ana e prokurorit janë llogaritur si shpenzime të të paditurit M. F. dhe familjarëve të tij, edhe kontratat e huasë të lidhura prej tij me shtetasin N. K., sipas deklaratës noteriale Nr. xxxx Rep dhe Nr. xxx Kol, datë xxxx, në shumën xxxx euro = xxxx lekë; dhënie hua shtetasit A. M., sipas deklaratës noteriale Nr. xxxx Rep dhe Nr. xxxx Kol, datë xxxx, në shumën xxxx euro = xxxx lekë, si

dhe dhënie hua shtetases F. L., në shumën xxxx lekë dhe mbi bazën e tyre, si dhe të gjitha të ardhurave dhe shpenzimeve të kryera për këtë vit, nga i padituri dhe familjarët e tij, për vitin 2013, totali i shpenzimeve të pajustificuara, sipas akuzës është, **xxxx** lekë.

**21.** Përsa i përket kësaj llogaritjeje të bërë nga ana e prokurorit, pas datës 12.6.2013, gjykata vlerëson që, ajo nuk mund të merret parasysh, sepse, siç ka përcaktuar gjykata në vendimin e ndërmjetëm të saj, totali i të ardhurave të ligjshme dhe i shpenzimeve për të paditurin M. F. dhe familjarët e tij, do të llogaritet për periudhën, nga 1 janari i vitit 1991, deri me datë 12.6.2013, e cila, është data e fundit kur janë vënë pasuritë objekt konfiskimi nga i padituri dhe, duke qenë se, këto kontrata huaje, të llogaritura nga prokurori, si shpenzime për të paditurit, janë lidhur pas datës 12.6.2013, si datë e fundit e caktuar nga gjykata, (konkretisht janë lidhur në datën 8.10.2013), brenda të cilës do të shtrihet hetimi gjyqësor i kësaj çështjeje, këto shuma nuk mund të llogariten si shpenzime për të paditurin M. F. dhe familjarët e tij.

**22.** Për këtë arsye, nga ana e gjykatës, shumës prej xxxx lekë, të llogaritur si shpenzime të pajustificuara nga prokurori për të paditurin dhe familjarët e tij, për vitin 2013, do t'i zbresë shumat prej xxxx lekë që përfaqëson kontratën e huasë së lidhur nga i padituri me shtetasin N. K., si dhe do t'i zbresë shumën prej xxxx lekë që përfaqëson kontratën e huasë së lidhur nga i padituri me shtetasin A. M. dhe shumën prej xxxx lekë që, përfaqëson kontratën e huasë së lidhur me shtetasen F. L., shuma, e cila në total rezulton: xxxx lekë + xxxx lekë + xxxx lekë = xxxx lekë dhe, mbi bazën e kësaj llogaritjeje rezulton që, totali i shpenzimeve për pasuritë dhe jetesën për periudhën nga 1 janari 2013, deri më datë 12.6.2013 është: xxxx lekë -

xxxx lekë = **xxxx lekë**. Mbi bazën e këtij vlerësimi të bërë nga gjykata, **për periudhën nga 1 janari, deri më datë 12.6.2013**, totali i të ardhurave është xxxx lekë; totali i shpenzimeve për pasuritë dhe jetesën është xxxx lekë dhe **totali i shpenzimeve të pajustificuara ligjërisht është: xxxx - xxxx = - xxxx (xxxx) lekë**.

**23.** Si përfundim, duke iu referuar të gjitha akteve dhe provave të shqyrtuara, rezulton që, në total, nga 1 janari i vitit 1991 deri në datë 12.6.2013 rezulton që, i padituri M. F. dhe familjarët e tij, kanë realizuar të ardhura nga burime të ligjshme në shumën xxxx (xxxx) lekë, ndërkohë që, kanë kryer shpenzime në shumën xxxx (xxxx) lekë dhe shuma e shpenzimeve të pajustificuara për periudhën e mësipërme, është në shumën xxxx - xxxx = xxxx (xxxx) lekë.

**24.** Gjykata e çmon me vend të theksojë që, shuma totale e shpenzuar nga i padituri M. F. dhe familjarët e tij, për blerjen e pasurive të paluajtshme, objekt i kërkesës për konfiskim, duke iu referuar çmimit të përcaktuar në kontratat përkatëse, është në masën **xxxx lekë**, ndërsa, vlera totale e tyre, sipas vlerës së tregut, në momentin e blerjes së pasurive të paluajtshme, është në masën **xxxx lekë** dhe, nga ana e gjykatës në nxjerrjen e shumës prej **xxxx (xxxx) lekë**, si shpenzime të pajustificuar për të paditurin dhe familjarët e tij, për periudhën 1 janar 1991, deri me datë 12.6.2013, është bërë duke mbajtur parasysh çmimin e parashikuar në kontratë për këto pasuri, pasi, nëse do të mbahej

parasysh çmimi i vlerës së tregut për këto pasuri, në momentin e blerjes, totali i shpenzimeve të pajustificuara të të paditurit, do të ishte më i lartë.

**25.** Duke u bazuar në argumentet e mësipërme, si dhe në përfundimin e arritur më lart nga gjykata, për vlerën e shpenzimeve të pajustificuara të të paditurit M. F. dhe familjarëve të tij, për periudhën nga 1 janari i vitit 1991 deri në datë 12.6.2013, e cila është **xxxx lekë**, si dhe duke i bazuar tek vlera e pasurisë objekt konfiskimi, e cila është **xxxx lekë**, gjykata vlerëson se, që, i padituri të justifikonte pasurinë objekt konfiskimi, duhej që, jo vetëm të mos kishte shpenzime të pajustificuara, por duhet të kishte të ardhura të ligjshme, në vlerën e barabartë ose më të madhe se shuma **xxxx lekë**, e cila, është vlera e pasurive objekt konfiskimi, gjë që, nuk rezultoi e provuar në këtë rast, pasi duke iu referuar të gjitha akteve dhe provave të shqyrtuara dhe të analizuara më lart, rezultoi e provuar që, i padituri M. F. dhe familjarët e tij, për periudhën nga 1 janari i vitit 1991 deri në datë 12.6.2013, jo vetëm nuk kishte të ardhura të ligjshme, në vlerën **xxxx lekë** që, të justifikonte se pasuritë objekt konfiskimi, i kishte krijuar nga të ardhura të ligjshme, por, rezultoi që, kishte shpenzime të pajustificuara, në një vlerë të konsiderueshme dhe që është shuma **xxxx lekë**.

**26.** Po ashtu, gjykata e gjen me vend të sqarojë që, në nxjerrjen e shumës prej **xxxx lekë**, si shpenzime të pajustificuar për të paditurin M. F., gjykata është bazuar edhe tek analiza që i është bërë aktit të ekspertimit kontabël dhe shtetasave të këtij akti, ku, gjykata, duke e ballafaquar këtë akt ekspertimi me provat e tjera të administruara në këtë gjykim, si dhe duke u bazuar në rregullat financiare të njohura dhe që janë standarte të pranuar nga të gjithë ekonomistët dhe juristët, arrihet në përfundimin se, eksperti kontabël ka vlerësuar si të ardhura disa shuma monetare që, nuk mund të konsiderohen si të tilla, si dhe nuk ka pasqyruar të plota, në zërin e shpenzimeve, shpenzimet e kryera nga i padituri M. F. dhe familjarët e tij. Konkretisht, eksperti kontabël ka llogaritur për të paditurin M. F. të ardhura të realizuar prej tij, nga aktiviteti tregtar, si person fizik, me Nipt xxxx, aktivitet “xxxx”, për periudhën 2006-2008, në shumën  $xxxx \text{ lekë} + xxxx \text{ lekë} + xxxx \text{ lekë} = xxxx \text{ lekë}$ . Këtë llogaritje eksperti e ka kryer duke mos u bazuar në ndonjë dokument fiskal, por vetëm duke llogaritur fitime në mënyrë hipotetike. Gjukata vlerëson që, ksperti kontabël mund të llogarisë të ardhura apo shpenzimet vetëm mbi dokumenta që provojnë se, një subjekt ka përfituar të ardhura, por nuk mund që të japë mendime hipotetike. Vetëm fakti se, shtetasi M. F. ka qënë i rregjistruar si person fizik, nuk mundet që të provojë se, ka realizuar të ardhura, pasi nuk mund të përcaktohet, nëse, e ka realizuar faktisht aktivitetin tregtar të personit fizik, nuk mund të përcaktohet se sa ka qënë qarkullimi vjetor, nuk mundet të përcaktohet, nëse, aktiviteti ka qënë me fitim apo ka rezultuar me humbje, prandaj shuma prej **xxxx lekë**, e llogaritur nga eksperti kontabël si të ardhura për për periudhën 2006-2008, nuk është mbajtur parasysh nga gjykata, në nxjrrjen e shumës së përgjithshme prej **xxxx lekë**, si shpenzime të pajustificuar për të paditurin M. F..

**27.** Po ashtu, duke iu referuar aktit të ekspertimit kontabël, rezulton që, eksperti ka llogaritur si të ardhura për të paditurin M. F., një kredi të marrë në xxxx Bank në datën xxxx, nga shoqëria “xxxx” sh.p.k, në shumën xxxx euro = xxxx lekë. Gjukata vlerëson që, kredia në këtë rast, është marrë nga shoqëria tregtare dhe, është përdorur prej saj, në ushtrimin e aktivitetit tregtar dhe nuk mund të konsiderohet si e ardhur për të paditurin M. F. dhe për këtë arsye, edhe kjo shumë prej xxxx lekë, e llogaritur nga eksperti si të ardhura, për vitin 2008, nuk është mbajtur parasysh nga gjykata, në

nxjerrjen prej saj të totalit të shpenzimeve të pajustificuara për të paditurin M. F.. Për vitin 2008, eksperti kontabël ka llogaritur të ardhura për nga shoqëria “xxx” sh.a, në formë fitimi, shumën xxxx lekë, ndërkohë që, i padituri M. F., në vitin 2008, nuk dispononte aksione të kësaj shoqërie tregtare, pasi i 50 % të aksioneve të kësaj shoqërie i ka blerë në vitin 2009 dhe për këtë arsye edhe kjo shumë nuk është llogaritur nga gjykata në nxjerrjen e totalit të shpenzimeve të pajustificuara për të paditurin.

**28.** Eksperti kontabël ka llogaritur të ardhura për të paditurin M. F., fitimet e realizuara nga shoqëria “xxx” sh.a, në masën 50 % të tij, të realizuara në vitin 2009, në shumën xxxx lekë, për vitin 2010, në shumën xxxx lekë, për vitin 2011 në shumën xxxx lekë dhe për vitin 2012 në shumën xxxx lekë. Po ashtu, eksperti kontabël ka llogaritur të ardhurat nga fitimet e realizuara nga shoqëria “xxxx” sh.p.k, për vitet 2010-2013.

**29.** Gjykata vlerëson që, të gjitha shumat e mësipërme, të llogaritura nga eksperti kontabël, si të ardhura për të paditurin M. F., nuk mund të merren parasysh nga gjykata dhe të llogariten prej saj në nxjerrjen e totalit të shpenzimeve të pajustificuara për të paditurin, sepse, nga analiza e bilanceve të shoqërive tregtare, të viteve 2008-2013, nuk rezulton që, shoqëria “xxxx” sh.a të ketë shpërndarë dividend. Shoqëria tregtare ka realizuar fitim, por fitimi ka qënë i pashpërndarë. Ky fakt konfirmohet edhe me shkresën nr.xxxx prot datë xxxx të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, (F-2, faqe 59), në të cilën përshkruhet se, “Në dosjen e shoqërisë përcjellë nga Drejtoria Rajonale Tiranë nuk ka vendime asambleje ortakësh për periudhat tatimore 2008-2012. Nga verifikimi në pasqyrat financiare 2008-2013 në postin e kapitaleve të veta na rezulton që nga shoqëria nuk është shpërndarë dividend”. Rezulton se shtetasi M. F. ka përfitur nga shoqëria “xxxx” sh.a disa transferta, të dërguara nga ekonomistja e shoqërisë, transferta të cilat janë llogaritur si të ardhura për shtetasin M. F., por këto transferta nuk i referohen ndarjes së dividendit. Po ashtu, edhe shoqëria “xxx” sh.p.k, nga viti 2010-2014, rezulton se, shoqëria nuk ka shpërndarë dividend. Për më tepër, ndodhet e administruar në dosje edhe vendimi i Asamblesë së Ortakëve Nr. x, datë xxxx, sipas të cilit fitimi i realizuar, në vitin ushtrimor 2012 i kësaj shoqërie, nuk do të shpërndahet, por do të kalojë për krijim rezervash.

**30.** Eksperti kontabël ka llogaritur si të ardhura për të paditurin M. F. një kredi në xxxx Bank, në shumën xxxx euro, të marrë në datën xxxx. Nga verifikimi i të dhënave bankare rezulton se, kjo kredi që në momentin e disbursimit të saj është transferuar në llogarinë e personit të tretë Sh. S., i cili, më pas ka derdhur në llogarinë bankare të shtetasit M. F., këstet përkatëse për pagimin e kredisë. Pra, rezulton që, kjo kredi nuk ka krijuar as të ardhura dhe as shpenzime për të paditurin M. F., pasi, në fakt, është marrë nga personi i tretë Sh. S. dhe këstet janë paguar krejt këtij të fundit dhe, për këtë arsye edhe kjo shumë prej xxxx euro, e llogaritur nga eksperti kontabël si e ardhur, nuk mund të merret parasysh nga gjykata në nxjerrjen e totalit të shpenzimeve të pajustificuara për të paditurin M. F..

**31.** Eksperti kontabël ka llogaritur të ardhura për të paditurin M. F. shumën xxxx lekë, nga shitja e pasurisë Nr. xxxx, zk.xxxx, xxxx, e llojit apartament me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>. Nga verifikimet e kryera rezulton se, kjo pasuri është shitur nga një person tjetër, me të njëjtin emër dhe mbiemër, me emrin M. F., i biri i P. dhe D., lindur më xxxx, me banim në xxxx. Në këtë rast, kemi të bëjmë me një person tjetër, pasi subjekti në këtë gjykim, ka gjeneralitetet M. F., i biri i P. dhe L., lindur më xxxx,

lindur në xxxx dhe banues në xxxx, prandaj edhe shuma prej xxxx lekë, e llogaritur nga eksperti kontabël si e ardhur për të paditurin, nuk mund të merret parasysh nga gjykata në nxjerrjen e totalit të shpenzimeve të pajustificuara për të.

**32.** Eksperti kontabël ka llogaritur si të ardhura për të paditurin M. F., blerjen me anë të qirasë financiare (leasing) të automjetit me targa xxxx, në shumën xxxx euro, likujduar në momentin fillestar, shuma xxxx euro, si dhe automjetin me targa xxxx, në shumën xxxx euro, likujduar në momentin fillestar, shuma prej xxxx euro. Gjykata vlerëson që, blerja e automjeteve me anë të qirasë financiare, nuk mundet të konsiderohet si e ardhur për të paditurin, përkundrazi, i padituri M. F. ka likujduar, pjesërisht çmimin e automjeteve, shuma të cilat duhet që të ishin cilësuar si “shpenzime” nga ana e ekspertit kontabël dhe, për këtë arsye edhe këto shuma, nuk janë marrë parasysh nga gjykata në nxjerrjen e totalit të shpenzimeve të pajustificuara për të paditurin.

**33.** Gjithashtu, eksperti kontabël nuk ka llogaritur në zërin e shpenzimeve, në aktin e ekspertimit disa hua të dhëna nga i padituri M. F. personave të tjerë, siç është huaja në shumën xxxx euro dhënë shtetasit N. K., si dhe huaja në shumën xxxx euro dhënë shtetasit A. M., shuma që, përfshihen në zërin e shpenzimeve, si dhe duke qenë se, ishim para një veprimi të thjeshtë matematikor, nga ana e gjykatës këto shuma janë llogaritur si shpenzime, në nxjerrjen e totalit të shpenzimeve të pajustificuara për të paditurin M. F..

**34.** Duke u bazuar në këto konstatime që gjykata i bëri aktit të ekspertimit kontabël, si dhe duke u bazuar në rregullimet e nevojshme që bëri gjykata në lidhje me shumën e të ardhurave dhe shpenzimeve të të paditurit M. F. dhe familjarëve të tij, në aktin e ekspertimit përkatës, duke u dhënë edhe argumentet përkatëse nga ana e gjykatës, për rregullimet e bëra prej saj, si dhe duke u bazuar në të gjitha aktet dhe provat e çështjes, gjykata konkludon që, për periudhën nga 1 janari i vitit 1991, deri në datë 12.6.2013, totali i shpenzimeve të pajustificuara është xxxx (xxxx) lekë.

**35.** Duke u bazuar në këtë konkluzion të gjykatës, sipas të cilit i padituri M. F., nuk arriti që të justifikojë që pasuritë objekt konfiskimi i ka realizuar me anë të të ardhurave të ligjshme, si dhe duke u bazuar edhe në konkluzionin e arritur më parë nga gjykata, sipas të cilit organi i prokurorisë arriti që ta provojë barrën e saj të provës, duke provuar para gjykatës që i padituri ka kryer një nga veprat penale të parashikuara nga neni 3, pika 1 e ligjit Nr. 10192, datë 3.12.2009, i ndryshuar, si dhe ka në përdorim dhe në pronësi të tij, pasuri të cilat nuk justifikohen me të ardhura të ligjshme, arrihet në përfundimin që, kërkesa e prokurorisë për konfiskimin e pasurive, sipas listës së përcaktuar, në pjesën hyrëse të këtij vendimi, është e bazuar në prova dhe ligj, prandaj duhet të pranohet.

**36.** Gjykata e gjen me vend të bëjë pjesë të këtij vendimi edhe pretendimet e paraqitura nga përfaqësuesit e të paditurit dhe personave të tretë në këtë gjykim dhe të analizojë nëse, këto pretendime janë të bazuara në ligj dhe prova apo jo. Kështu, një nga pretendimet e paraqitura nga përfaqësuesi i të paditurit është që, prokuroria e ka bazuar paraqitjen e kërkesës për konfiskimin e pasurive të të paditurit, vetëm në aktin e ekspertimit të datës xxxx, të kryer nga eksperte G. D., në kuadër të procedimit penal Nr. x, të vitit xxxx, kundër shtetasit M. F. dhe, sipas mbrojtjes ky akt ekspertimi, nuk ka asnjë vlerë, pasi është

hartuar nga një person që nuk ka patur cilësitë e ekspertit, duke kërkuar mbrojtësi i të paditurit që ky akt ekspertimi, të mos merret parasysh nga gjykata, duke kërkuar edhe që gjykata ta shpallte të pavlefshëm atë.

**37.** Për këtë pretendim të mbrojtësit të të paditurit M. F., fillimisht gjykata çmon të sqarojë që, organi i prokurorisë, nuk e ka bazuar kërkesën e saj për konfiskim, vetëm në aktin e ekspertimit të datës xxxx, të kryer nga eksperte G. D., në kuadër të procedimit penal Nr. x, të vitit xxxx, kundër shtetasit M. F., por e ka bazuar, përveçse, në këtë akt ekspertimi edhe, në një numër të konsiderueshmë provash dhe aktesh shkresore, të përmbledhura në x fashikuj, prandaj ky pretendim çmohet nga gjykata si i pabazuar në prova dhe ligj, prandaj nuk mund të merret parasysh nga gjykata.

**38.** Në lidhje me pretendimin e mbrojtësit të të paditurit që ky akt ekspertimi të mos vlerësohet si provë nga gjykata, si dhe ai të shpallet i pavlefshëm, gjykata e gjen atë të pabazuar në ligj, sepse, duke iu referuar dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, të cilat rregullojnë ekspertimin si provë, nga neni 225-230 të tij, në asnjë prej këtyre dispozitave, nuk parashikohet mundësia e shpalljes së pavlefshme të aktit të ekspertimit, ndërkohë që, mbrojtësi për shpalljen të pavlefshme të tij, referon tek dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, referencë ligjore që çmohet nga gjykata si e gabuar, sepse, procedura e gjykimit të konfiskimit nga gjykata, rregullohet sipas ligjit të veçantë Nr. 10192, atë 3.12.2009, i ndryshuar dhe plotësohet me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, ndërkohë që, dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, gjejnë zbatim, sipas dispozitës tranzitore të ligjit Nr. 70, të vitit 2017, i cili, ka hyrë në fuqi me datë 23.6.2017, vetëm për kërkesat e paraqitura pas hyrjes në fuqi të tij dhe, nuk mund të zbatohet në këtë rast, pasi kërkesa për konfiskim ndaj pasurive të të paditurit M. F., është paraqitur me datë xxxx, pra, para hyrjes në fuqi, të ligjit Nr. 70, të vitit 2017. Për këtë arsye, pretendimet e mbrojtësit të të paditurit që, akti i ekspertimit i datës xxxx i kryer nga eksperte G. D., në kuadër të procedimit penal Nr. x, të vitit xxxx, kundër shtetasit M. F., të shpallet i pavlefshëm, çmohet si i pabazuar, si dhe po ashtu, edhe pretendimi tjetër që ky akt të mos vlerësohet si provë nga gjykata, është i pabazuar, pasi ky akt, ka vlerën e provës shkresore, në këtë gjykim dhe do të vlerësohet, njëjloj si provat e tjera, në harmoni dhe në përputhje me të gjitha aktet dhe provat e tjera të këtij gjykimi.

**39.** Në diskutimin përfundimtar mbrojtësi i të paditurit M. F., paraqiti pretendime edhe ndaj vendimeve të formës së prerë të gjykatave, të cilët e kanë deklaruar fajtor të paditurin M. F. për kryerjen e veprave penale të: “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rreme i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë”, “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, “Ndërtimi i paligjshëm”, të parashikuara nga nenet 257/a/2, 287, gërma (b) dhe 199/a/2 i Kodit Penal, duke i komentuar këto vendime, si të padrejta, pretendime të cilat nuk mund të merren parasysh nga kjo gjykatë, sepse, ato janë vendime gjyqësore të formës së prerë dhe drejtësia e tyre, nuk mund të vihet në diskutim nga askush, përfshirë edhe këtë trup gjykues dhe për këtë arsye, përveçse, duke i vlerësuar si të pabazuara, kjo gjykatë vlerëson të mos japë, ndonjë argument tjetër për këto pretendime.

**40.** Pretendimet e tjera të bëra nga mbrojtësi i të paditurit M. F. lidhen me aktin e ekspertimit vlerësues, sipas të cilit për pasurinë e paluajtshme, të llojit dyqan, më sipërfaqe xxx m<sup>2</sup>, ekspertja e ka vlerësuar jo në mënyrë të saktë, pasi kjo pasuri është e paregjistruar në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe për këtë arsye, nuk mund të ketë të njëjtën vlerë tregu, si pasuritë e regjistruara, si dhe paraqiti pretendime edhe për vlerësimin e pasurisë me sipërfaqe xxx m<sup>2</sup> truall dhe xxx m<sup>2</sup> ndërtesë, të ndodhur në xxxx, ku, sipas mbrojtjes, kjo pasuri nuk mund të ketë vlerën e tregut të përcaktuar nga ekspertja, pretendime të cilat çmohen nga gjykata si të pabazuara, sepse, vlera e këtyre dy pasurive, ashtu si edhe e të gjitha pasurive të tjera objekt konfiskimi, është llogaritur nga ana e gjykatës, sipas vlerës së përcaktuar në kontratë nga palët, në momentin e blerjes dhe jo sipas vlerës së tregut, në kohën e blerjes, të përcaktuar nga ekspertja vlersuese, në aktin e ekspertimit.

**41.** Mbrojtësi i të paditurit M. F., duke i bërë një interpretim, me anë të një table të hartuar prej tij, aktit të ekspertimit vlerësues dhe atij kontabël, të hartuar nga ekspertët në seancë gjyqësore, pretendon që, për të paditurin M. F. dhe familjarët e tij, për periudhën 1.1.1991, deri më 12.6.2013, totali i të ardhurave të ligjshme është xxxx lekë, totali i shpenzimeve, i investimeve, blerjeve dhe pagesave të tjera është xxxx dhe teprica e të ardhurave të ligjshme është xxxx lekë, pretendime që vlerësohen nga gjykata si të pabazuara në prova dhe ligj, pasi, ato kanë të bëjnë me një vlerësim subjektiv, të njëanshëm që mbrojtësi i të paditureve iu bën akteve të ekspertimit, si dhe sepse, duke iu referuar të dy akteve të ekspertimit, shtetasve përkatëse të tyre, rregullimeve dhe saktësimeve që kjo gjykatë ka bërë për aktin e ekspertimit përkatës, duke dhënë edhe arsyet konkrete se pse, janë bërë këto rregullime, si dhe duke iu referuar të gjitha akteve dhe provave të këtij gjykimi dhe, duke i vlerësuar ato, në tërësi dhe në harmoni me njëra-tjetër, rezulton që, totali i të ardhurave të ligjshme të të paditurit M. F. dhe familjarëve të tij, për periudhën 1.1.1991, deri më 12.6.2013, është xxxx (xxxx) lekë, totali i shpenzimeve është në shumën xxxx (xxxx) lekë dhe, shuma e shpenzimeve të pajustificuara për periudhën e mësipërme, është në shumën xxxx - xxxx = xxxx (xxxx) lekë.

**42.** Mbrojtësi i të paditurit M. F., po ashtu pretendoi që, mos shpërndarja e dividendit nga ana e shoqërisë xxxx sh.a, nuk tregon që, kjo shoqëri nuk ka patur fitime, pasi ajo në të vertetë, ka patur fitime dhe këto fitime janë tërhequr nga ortaku i saj, i padituri M. F., i cili, çmohet nga gjykata si i pabazuar në prova dhe ligj, sepse, në kushtet kur, në bazë të ligjeve dhe rregullave që rregullojnë veprimtarinë tregtare të shoqërisë tregtare, shoqëria tregtare ka deklaruar në regjistrat tregtarë që, nuk ka shpërndarë fitime ose dividend, ky deklaram i saj përbën provë të plotë dhe nuk mund të pretendohet e kundërta, me anë të deklarimeve të mëvonshme që mund të bëjnë ortakët e shoqërisë.

**43.** Pretendimet e mbrojtësit të të paditurit sipas të cilëve gjykata, po ashtu si eksperti dhe në ndryshim nga sa pretendon akuza në gjykim dhe në diskutimin përfundimtar, nuk duhet që t'i llogarisë si shpenzime të të paditurit shumat e dhënë hua, ndaj shtetasve N. K., A. M. dhe F. L., shpenzime që kapin shumën xxxx lekë, çmohet nga gjykata si i



bazuar, për arsyet e dhëna më lart, pasi këto kontrata janë lidhur me datë xxxx, ndërsa, periudha e verifikimit pasuror e vendosur me vendim të gjykatës është, deri më datë xxxx, e cila, është edhe data e fundit e vënies së pasurisë objekt konfiskimi nga i padituri M. F. dhe familjarët e tij dhe, për këtë arsye, kjo shumë nuk është llogaritur nga gjykata, tek shpenzimet e të paditurit dhe familjarëve të tij, duke u pranuar, në këtë mënyrë, ky pretendim i bërë nga mbrojtësi i të paditurit M. F..

**44.** Pretendimet e mbrojtjes së të paditurit M. F. se, për blerjen e pasurive të paluajtshme, i padituri nuk ka paguar çmimin e përshkruar në kontratë, por këto pasuri janë fituar prej tij, si detyrime që personat përkatës i detyroheshin për shkak të humbjeve në llotari sportive, gjykata i gjen si të pabazuar në prova dhe ligj, prandaj, nuk mund t'i marrë parasysh ato. Neni 232 i K.Pr.Civile parashikon që, “Nuk lejohet prova me dëshmitarë kundër ose tej përmbajtjes së një akti zyrtar ose privat që përbën provë të plotë”. Për të gjitha pasuritë e paluajtshme objekt të kërkesës për konfiskim, ekzistojnë si provë kontratat përkatëse të shitblerjes dhe kontratat e pororisë, të lidhura në formën e aktit noterial, në përmbajtjen e të cilave është përcaktuar, shprehimisht se, i padituri M. F. ka paguar në shuma monetare, çmimin përkatës, të parashikuar në secilën prej kontratave, prandaj duke qenë se, këto kontrata përbëjnë provë të plotë, e kundërta e tyre, nuk mund të provohet me dëshmitarë.

**45.** Për këtë arsye, thëniet e dëshmitarit F. B., pretendimet e përfaqësuesit të të paditurit M. F., si dhe pretendimet e personave të tretë, në këtë gjykim, sipas të cilëve, këto pasuri janë fituar nga i padituri M. F., si shpërblim për humbjet në llotaritë sportive që personat përkatës kanë patur, nuk mundet merren parasysh nga gjykata, sepse, tejkalojnë vlerën provuese të kontratave, të lidhura me akte noteriale, të cilat përbëjnë provë të plotë. Një arsye tjetër se pse këto pretendime nuk merren parasysh nga gjykata është se, ato nuk provohen me asnjë provë tjetër, si dhe vijnë në kundërshtim me prova shkresore me vlerë të plotë provuese.

**46.** Pretendimi tjetër i mbrojtësit të të paditurit kishte të bënte me faktin që, vlera e shpenzimeve për banesën x katëshe, në proces legalizimi, shpenzimet për ndarjen e saj, duhet të ndahen të katër pjesë dhe jo në tre pjesë siç i ka llogaritur ekspertja, si dhe ky është një objekt në proces legalizimi dhe për këtë arsye, nuk mund të mbahet parasysh vlera e tregut e tij, pretendime që çmohen nga gjykata si të pabazuara, sepse, shpenzimet për banesën x katëshe, duhet të ndahen në tre pjesë, pasi, tre janë subjektet në emër të të cilëve është kërkuar legalizimi i saj nga ALUIZNI, çka nënkupton që edhe personat që kanë kontribuar për ndërtimin e saj kanë qenë tre dhe jo katër persona, si dhe nga ekspertja nuk është llogaritur vlera e tregut të kësaj banese, siç pretendon mbrojtja, por është llogaritur vlera e koston së ndërtimit të kësaj banese.

**47.** Pretendimi tjetër i mbrojtësit së të paditurit sipas të cilit nga ana e gjykatës nuk u caktua një ekspert kompetent për të llogaritur shumat monetare të siguruara nga i padituri M. F. dhe familjarët e tij, nga aktiviteti bujqësor dhe blegtoral, për periudhën 1.1.1991, deri më 12.6.2013 dhe, ky fakt duhet të mbahet parasysh nga gjykata duke prezumuar që, i padituri dhe familjarët e tij, kanë krijuar të ardhura edhe nga aktiviteti bujqësor dhe blegtoral, çmohet nga gjykata si i pabazuar, sepse, aktiviteti bujqësor dhe blegtoral, ashtu si çdo

aktivitet tjetër, mund të rezultoi me fitim ose humbje dhe, përderisa, nga ana e të paditurit nuk u paraqit asnjë provë ose akt që ky aktivitet ka ekzistuar dhe ka rezultuar me fitim, nga ana e gjykatës nuk mund të caktohej një ekspert, për të llogaritur fitime hipotetike apo të paprovuara në gjykim.

**48.** Pretendimi i fundit i mbrojtësit së të paditurit M. F. që, duke qenë se, pala paditësi prokuroria hoqi dorë nga kërkesa për konfiskimin e pasurisë të llojit arë, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, ndodhur në vëndin e quajtur “xxxx”, xxxx, gjykata duhet të zbrezë shpenzimet e llogaritura nga ekspertja vlerësuese, për blerjen e kësaj pasurie, çmohet nga gjykata, pjesërisht i bazuar dhe, gjykata për këtë pasuri, ka zbritur nga shpenzimet e të paditurit, jo vlerën e llogaritur nga ekspertja si vlerë e tregut, në momentin e blerjes, por, vlerën që është përcaktuar në kontratë, në momentin e blerjes për këtë pasuri, sepse, siç është thënë më lart, të gjitha pasuritë e blera nga i padituri dhe familjarët e tij, janë llogaritur si shpenzime, sipas vlerës që ata kanë përcaktuar në kontratë, në kohën e blerjes dhe jo sipas vlerës së tregut, në momentin e blerjes, të nxjerrë nga ekspertja vlerësuese.

**49.** Mbrojtësi i personit të tretë xxxx sh.a, paraqiti pretendime përse i përket pasurisë të llojit dyqan, me sipërfaqe xxx m<sup>2</sup>, të porositur nga i padituri M. F., me kontratën Nr. xxx Rep, Nr. xx Kol, datë xxxx, si ortak i shoqërisë xxxx sh.a, duke pretenduar që, kjo pasuri është siguruar nga burime të ligjshme nga i padituri, si dhe fakti që, kjo shoqëri nuk ka shpërndarë dividend, nuk do të thotë që ajo nuk ka nxjerrë fitime, duke kërkuar përfundimisht nga gjykata rrëzimin e kërkesës së prokurorit për konfiskimin e pasurive në përdorim dhe në pronësi të të paditurit M. F..

**50.** Këto pretendime të mbrojtësit të personit të tretë xxx sh.a, gjykata i gjen si të pabazuara në prova dhe ligj, pasi nga të gjitha aktet dhe provat e shqyrtuara, rezulton që, i padituri M. F. edhe pse ka patur disa aktivitete biznesi, një prej të cilave ka qenë edhe shoqëria xxxx sh.a, ky i paditur ka një numër të madh pasurish, me vlera të konsiderueshme, të cilat nuk justifikohen nga të adhurat e ligjshme të siguruar prej tij dhe familjarëve të tij, si dhe duke qenë se, ai është edhe subjekt i ligjit Nr. 10192, datë 3.12.2009, pasi jo vetëm ka dyshime të arsyeshme të bazuara në indicie, por ka prova të plota se, ai ka kryer dy nga veprat penale të parashikuara nga pika 1, e nenit 3 të këtij ligji, siç janë trafikimi i narkotikëve dhe pastrimi i produkteve të veprës penale, kërkesa e akuzës për konfiskimin e pasurisë, e cila, nuk mund të justifikohet prej tij, është e bazuar në ligj dhe prandaj do të pranohet nga gjykata.

**51.** Mbrojtësi i personit të tretë D. F., nuk paraqiti pretendime të veçanta për kërkesën për konfiskim, por u bashkua me kërkimet dhe pretendimet e paraqitura nga mbrojtësi i të paditurit M. F., duke pretenduar që, nga i padituri dhe personi i tretë D. F., të gjitha pasuritë në zotërim të tyre, janë krijuar me anë të të ardhurave që rrjedhin nga burime të ligjshme, pretendime që vlerësohen nga gjykata si të pabazuara, sepse, në bazë të akteve dhe provave të shqyrtuara, për pasuritë objekt konfiskimi, as i padituri M. F. dhe as personi i tretë D. F., nuk arritën që të provojnë burimin e ligjshëm të krijimit të tyre dhe për këto arsye, këto pasuri do t'i nënshtrohen konfiskimit nga

gjykata.

**52.** Në lidhje me pasurinë Nr. xxxx, zona kadastrale nr.xxxx, e llojit arë, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, ndodhur në vëndin e quajtur “xxxx”, xxxx, nga shqyrtimi i provave shkresore, rezulton se, kjo pasuri nuk i përket të paditurit M. F., por i përket një shtetasi tjetër me emrin M. F., i biri i P. dhe D., lindur më xxxx, me banim në xxxx, i cili, është një person tjetër dhe për pasojë, prokurori kërkoi heqjen dorë nga konfiskimi i kësaj pasurie, pasi kjo pasuri e paluajtshme nuk mundet që të jetë objekt i masës së konfiskimit, kërkesë e cila, çmohet e bazuar nga gjykata dhe do të pranohet, duke urdhëruar edhe heqjen e masës së sekuestros të vendosur mbi këtë pasuri, me vendimin gjyqësor Nr. xx, datë xxxx të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë.

**53.** Bazuar në arsyetimin e mësipërm, si dhe bazuar në të gjitha aktet dhe provat e shqyrtuara, gjykata çmon se, i padituri M. F. dhe familjarët e tij, nuk arritën që të provojnë prejardhjen e ligjshme të pasurive objekt konfiskimi dhe për këtë arsye, kërkesa e akuzës për konfiskimin e tyre, është e bazuar në nenin 24, pika 1 e ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009, prandaj ajo do të pranohet. Kjo dispozitë ligjore parashikon:

**“1. Gjykata vendos konfiskimin e pasurive kur plotësohen të gjitha kushtet e mësipërme:**

**a) kur ka dyshime të arsyeshme, të bazuara në indicie, për pjesëmarrjen e personit në veprimtari kriminale të parashikuara në nenin 3 të këtij ligji;**

**b) kur nuk provohet që pasuria ka prejardhje të ligjshme, apo personi nuk justifikon zotëtrimin e pasurive dhe të ardhurave, që nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruara dhe as nuk justifikohen prej tyre; dhe**

**c) kur rezulton që pasuria është drejtpërdrejt ose tërthorazi, në zotërim të pjesëshëm apo të plotë të personit”.**

**54.** Konfiskimi i pasurisë objekt gjykimi do të bëhet, në këtë rast nga gjykata, sepse, provohen të gjitha kushtet e kërkuara nga neni 24, pika 1 e ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009 dhe konkretisht:

**Së pari:** Rezultoi e provuar që, i padituri M. F. është subjekt i ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009, pasi me vendim të formës së prerë provohet që, ai ka kryer dy nga veprat penale të parashikuara nga pika 1 e nenit 3 të ligjit që janë trafikimi i narkotikëve dhe pastrimi i produkteve të veprës penale;

**Së dyti:** Rezultoi e provuar që, i padituri nuk arriti që të justifikojë prejardhjen e ligjshme të pasurive objekt konfiskimi dhe

**Së treti:** Rezultoi e provuar që, pasuritë objekt konfiskimi zotërohen, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga i padituri M. F..

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Gjykata bazuar në nenet 3, pikat 1; 2 dhe 4, 21, 24, pika 1 të nr. 10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar;

## VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës së paraqitur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

2. Konfiskim i pasurive, në përdorim dhe në pronësi të të paditurit M. F. dhe familjarëve të tij, si më poshtë:

- Pasuria e paluajtshme me nr.xxxx, zona kadastrale me Nr. xxxx, volumi x, faqe xx, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, ndodhur në xxxx, xxxx.

- Pasuria e paluajtshme me Nr. xxxx, zona kadastrale nr.xxxx, volumi x, faqe xx, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, ndodhur në xxxx, xxxx.

- Pasuria e paluajtshme e llojit dyqan, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “xxxx”, xxxx, ndodhur në objektin banimi dhe shërbimi x dhe x kate, të ndërtuar nga subjekti ndërtues “xxxx” sh.p.k, me lejën e ndërtimit të miratuar me vendimin Nr. xxxx, datë xxxx të KRRT-së së Bashkisë xxxx.

- Pasuria e paluajtshme e llojit apartament, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, me numër pasurie xxxx, zona kadastrale nr.xxxx, ndodhur në xxxx, xxxx, e regjistruar në regjistrin hipotekor në Nr. xxx, datë xxxx, ndodhur në katin e xxxx banimi, shkalla x, apartamenti me nr.xx.

- Pasuria e paluajtshme, e llojit apartament, me sipërfaqe xxx m<sup>2</sup>, me numër pasurie xxxx, zona kadastrale Nr. xxxx, ndodhur në xxxx, xxxx, e regjistruar në regjistrin hipotekor në Nr. .xxx, datë xxxx, ndodhur në katin e xxxx banimi, shkalla x, apartamenti me Nr. xx

- Pasuria e paluajtshme e llojit bodrum, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, me numër pasurie xxxx, zona kadastrale Nr. xxxx, ndodhur në xxxx, xxxx, e regjistruar në regjistrin hipotekor në Nr. xxxx, datë xxxx, ndodhur në katin e xxxx nëntokë, shkalla x, bodrumi Nr .x.

- Pasuria e paluajtshme e llojit bodrum, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, me numër pasurie xxxx, zona kadastrale nr.xxxx, ndodhur në xxxx, xxxx, e regjistruar në regjistrin hipotekor në Nr. xxx, datë xxxx, ndodhur në katin e xxx nëntokë, shkalla x, bodrumi Nr. x.

- Pasuria e paluajtshme e llojit dyqan, me sipërfaqe xxx m<sup>2</sup>, të ndodhur në objektin me x kate, të ndërtuar nga shoqëria “xxxx” sh.p.k, me lejen e ndërtimit të miratuar me vendimin Nr. xxx, datë xxxx të KRRT-së së Bashkisë xxxx, me pronar truall familja xxxx.

- Pasuria e paluajtshme nr.xxxx, zona kadastrale Nr. xxxx, volumi xx, faqe xx, e llojit truall, me sipërfaqe xxx m<sup>2</sup> dhe ndërtesë, me sipërfaqe xxx m<sup>2</sup>, ndodhur në xxxx, xxxx.

3. Pushimin e gjykimit për konfiskimin e pasurisë Nr.xxxx, zona kadastrale Nr. xxxx, e llojit arë, me sipërfaqe xxxx m<sup>2</sup>, ndodhur në xxxx, si dhe shuarjen e masës së sekuestrimit, për këtë pasuri, të vendosur me vendimin Nr. xx, datë xxxx të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë.

4. Shpenzimet e bëra gjatë fazës së hetimit pasuror në organin e prokurorisë, si dhe shpenzimet gjyqësore të bëra gjatë fazës së gjykimit, sipas procesverbaleve përkatëse, i

ngarkohen të paditurit M. F..

**5.** Kundër vendimit lejohet ankim në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, Tiranë, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e shpalljes, ndërsa për palët në mungesë, ky afat fillon nga e nesërmja e njoftimit të vendimit. Për personat e tretë në mungesë ky afat fillon nga e nesërmja e njoftimit të vendimit.

**6.** U shapall në Tiranë, sot me datë 16.3.2018.

**SEKRETARE**

**ANDINA KAJA**

**GJYQTAR**

**LUAN HASNEZIRI**



